

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7921  
E shtunë, 2 nëntor 2024  
Çmimi 0.50 €

Botohet libri "Ushtria  
Çlirimtare e Kosovës" i  
autorit Bardhyl Mahmuti



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## NËSE JO KURTI, KUSH DUHET TA FORMOJË ASOCIACIONIN?

FAQE 4-5



Deklarimet rreth themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë morën sërish vëmendje të konsiderueshme këtë javë, pavarësisht se për të është

diskutuar qindra herë që 11 vjet. Asociacioni u riaktualizua më 29 tetor, kur shefi i ekzekutivit të Kosovës, Albin Kurti, tha para medieve se si kryeministër i një republike

demokratike nuk mund të formojë asociacione të komunave. Sipas njohësit të çështjeve politike, Agon Maliqi, Kurti si kryeministër nuk mund t'i ikë kësaj përgjegjësie

**GLPS PËR RAPORTIN  
E KE-së: KUVENDI  
KRITIKOHET PËR  
MOSFUNKSIONIM,  
QEVERIA S'PO I MERR  
PARASYSH REKOMANDIMET  
E BE-së** F. 8



**ZGJEDHJET PËR  
SHTËPINË E  
BARDHË, HARRISI  
DHE TRUMPI  
SHTOJNË  
FUSHATAT** F. 7




**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

### SPORT



**SOT PËRBALLET KAMPIONI  
KUNDËR LIDERIT** F. 10

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



**GJERMANIA DO T'I MBYLLË  
TRI KONSULLATA IRANIANE PAS  
EKZEKUTIMIT TË SHTETASIT  
GJERMANO-IRANIAN** F. 2

**ULEN VLERAT E MANGANIT NË  
BADOVC, UJI ENDE I PAPIJSHËM** F. 3

**HARADINAJ TAKON AMBASADORIN  
AMERIKAN, KONFIRMON  
ANGAZHIMIN PËR ANËTARËSIMIN  
DIREKT TË KOSOVËS NË NATO** F. 7

### EKONOMI



**INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NGA  
ZVICRA NË KOSOVË NË KATËR VITET  
E FUNDIT JANË RRIATUR PËR RRETH  
170 PËR QIND** F. 8

**RIZVANOLLI NJOFTON  
SE DO TË INVESTOJNË  
NË 22 NDËRTESA SOCIALE  
NË DISA KOMUNA TË KOSOVËS** F. 8

## Gjermania do t'i mbyllë tri konsullata iraniane pas ekzekutimit të shtetasit gjermano-iranian

**BERLIN, 1 NËNTOR** - Gjermania do t'i mbyllë që të tri konsullatat iraniane në Gjermani si përgjigje ndaj ekzekutimit të shtetasit gjermano-iranian Jamshid Sharmahd nga Irani, tha të enjten vonë ministrja e Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock. "Ne e kemi bërë të qartë vazhdimisht se ekzekutimi i një shtetasi gjerman do të ketë pasoja serioze", tha Baerbock në Nju-Jork. "Prandaj, kam vendosur t'i mbyllë të tri konsullatat iraniane në Frankfurt, Muni dhe Hamburg", shtoi ajo. Baerbock theksoi se marrëdhëniet e Gjermanisë me Iranin kanë "rënë më poshtë se në pikën e ulët", pas ekzekutimit të Sharmahdit në Teheran më 28 tetor. Baerbock tha se ekzekutimi i Sharmahdit tregon se "regjimi i

padrejtësisë" në Iran vazhdon të veprojë me brutalitet. Që të gjithë 32 punonjësit në tri konsullatat duhet të largohen nga vendi, përveç nëse kanë shtetësi gjermane. Ambasada iraniane në Berlin nuk preket nga ky urdhër. Irani thirri në takim të ngarkuarin e Gjermanisë me punë në Teheran për të protestuar ndaj vendimit "të padrejtë" të Gjermanisë, njoftuan mediet shtetërore më 31 tetor. Media shtetërore iraniane tha se Sharmahd u ekzekutua pasi ishte dënuar për kryerjen e sulmeve terroriste. Ministri i Jashtëm iranian Abbas Araçchi tha se të qenit i pajisur me pasaportë gjermane nuk i jep askujt imunitet. Kancelari gjerman Olaf Scholz iu bashkua Baerbockut për ta

dënuar fuqishëm ekzekutimin e Sharmahdit, duke e quajtur atë "skandal" për qeverinë iraniane. Zëvendësi i të dërguarit të posaçëm, Abram Paley, nga Zyra e Dërguarit të Posaçëm të ShBA-së për Iranin, përshëndeti vendimin e Gjermanisë për mbylljen e tri konsullatave iraniane. "Ne qëndrojmë të bashkuar me komunitetin ndërkombëtar për ta mbajtur përgjegjës regjimin", tha ai në X, duke e cilësuar ekzekutimin e Sharmahdit "të padrejtë". Sharmahd, 69 vjeç, akuzohej nga Irani se udhëhiqte një grup promonarkist, për të cilin Teherani beson se ishte përgjegjës për një sulm vdekjeprurës me bombë në vitin 2008, si dhe për planifikimin e sulmeve të tjera



në vend. Katërmbëdhjetë iranianë dhe 210 të tjerë u plagosën në sulmin në xhaminë Sayyid al-Shuhada Husseinia në Shiraz gjatë një ceremonie për ta nderuar imamin Hussein,

imamin e tretë të myslimanëve shiitë. Ministria e Inteligjencës e Iranit e akuzoi Sharmahdin për planifikimin e sulmit, një akuzë të cilën familja e tij e hodhi poshtë si "qesharake".

## ShBA: Afër 8 000 trupa koreanoveriore janë në kufi me Ukrainën

**WASHINGTON, 1 NËNTOR** - Shtetet e Bashkuara thanë më 31 tetor se kanë informacione se afër 8 000 ushtarë të Koresë së Veriut tani janë në rajonin rus të Kurskut, afër kufirit me Ukrainën, dhe Rusia "synon" t'i dislokojë ata në fushëbetejë kundër forcave ukrainase. Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha se ShBA-ja pret që trupat të dërgohen në vijën e frontit në ditët në vijim. Ai përsëriti se ata do të bëhen "caqe legjitime ushtarake" nëse dislokohen.



Dislokimi ishte në krye të agjendës teksa Blinken dhe sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, u takuan me ministrin e Jashtëm të Koresë së Jugut, Cho Tae-yul, dhe atë të Mbrojtjes, Kim Yong-hyun. Rusia ka trajtuar trupat e Koresë së Veriut për përdorimin e

artilerisë, dronëve dhe për operacione bazike të këmbësorisë, "duke lënë të kuptohet se ajo synon që t'i përdorë këto forca në operacionet në vijën e frontit", tha Blinken. "Një nga arsyet që Rusia po përdor trupat e Koresë së Veriut është sepse është e

dëshpëruar. [Presidenti rus, Vladimir] Putin gjithnjë e më shumë po dërgon rusë në luftën vrasëse në Ukrainë", tha Blinken. Blinken shtoi se Putini po kthen sytë nga trupat koreanoveriore "dhe ky është sinjal i qartë i dobësisë". Ai shtoi se Rusia po

pëson afër 1 200 viktima në ditë në lindje të Ukrainës, më shumë që kur ka nisur lufta më 2022. Austin e quajti dislokimin e trupave të Koresë së Veriut dhe testimin e një rakete balistike ndërkontinentale nga Pheniani më herët gjatë 31 tetorit si "zhvillime të pamatura". Më herët gjatë ditës, Koreja e Veriut tha se ka testuar një nga raketat e saj më të reja dhe më të fuqishme për ta forcuar parandalimin e saj bërthamor. Pas këtij testimi, ShBA-ja, Koreja e Jugut dhe Japonia lëshuan një deklaratë të përbashkët duke dënuar testimin dhe duke thënë se paraqet "shkelje flagrante" të një sërë rezolutash të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ndryshe, dislokimi i trupave të Koresë së Veriut në Rusi ka rritur shqetësimet për destabilizimin e

mëtejshëm të rajonit të Azi-Paqësorit dhe të luftës së Moskës kundër Ukrainës. Koreja e Jugut ka ngritur dyshimet nëse teknologjia e re ushtarake e Koresë së Veriut mund të jetë ofruar nga Rusia në këmbim të furnizimit të Moskës me ushtarë. Rusia ka zhvendosur disa burime në rajonin kufitar të Kurskut për t'iu përgjigjur ofensivës tokësore që Ukraina nisi në gusht dhe forcat e Moskës po përballen me vështirësi që t'i zmbrapsin trupat ukrainase. ShBA-ja ka vlerësuar se aktualisht janë afër 10 000 trupa të Koresë së Veriut në rusi. Seul dhe aleatët e tij kanë vlerësuar se numri është rritur në 11 000, ndërsa Ukraina ka thënë se ky numër është më i lartë, 12 000. As Moska e as Pheniani nuk e kanë pranuar drejtpërdrejt dislokimin e trupave.

## Rritet numri i viktimave nga vërshimet në Spanjë

**VALENCIA, 1 NËNTOR** - Numri i viktimave nga vërshimet në Spanjë ka arritur në të paktën 158, teksa ekipet e shpëtimit po vazhdojnë operacionet për gjetjen e të mbijetuarve. Të martën Spanja u godit nga një stuhi e fuqishme me shira të rrëmbyeshëm që përmbytën shtëpi, duke goditur më së rëndi rajonin lindor të Valencias. Sipas ekipeve të shpëtimit në Valencia, në këtë rajon janë gjetur 155 trupa të pajetë. Ndërkaq, zyrtarët në Kastilla La Mança dhe në Andaluzi thanë se janë regjistruar edhe tri viktima në këto dy rajone. Paraprakisht gjatë 31 tetorit, zyrtarët kishin thënë se numri i

viktimave ishte 95, por duke pasur parasysh numrin e lartë të personave të zhdukur, ky numër pritet të rritet. "Ju lutem qëndroni në shtëpi dhe ndiqni udhëzimet e shërbimeve të emergjencës. Tani më e rëndësishmja është që të shpëtojmë sa më shumë njerëz që mundemi", u tha kryeministri spanjoll banorëve të zonave të prekura. Mbreti Felipe VI paralajmëroi se ekipet e shpëtimit ende po punojnë në rajonet në lindje dhe jug, të cilat u parashikuan të përballen nga moti me shi të enjten. Ekipet e shpëtimit, të mbështetura nga mbi 1 200 trupa, kanë vazhduar punën për

të gjetur të mbijetuar dhe për t'i pastruar rrugët. Qindra persona të prekur nga vërshimet janë vendosur në strehimore të përkohshme, teksa transporti rrugor dhe hekurudhor është ndërprerë gjerësisht. Autoritetet thanë se do të duhen tri javë që të rihapet një autostradë që lidh Madridin me Valencian për shkak të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore. Shkencëtarët kanë thënë se ndryshimet klimatike, të nxitura nga njeriu, po bëjnë që ngjarje të motit ekstrem të jenë më të shpeshta, më intensive dhe të zgjasin më shumë.



# GLPS për raportin e KE-së: Kuvendi kritikohet për mosfunksionim, qeveria s'po i merr parasysht rekomandimet e BE-së

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka mbajtur konferencë për medie me temën "Çfarë u tha në Raportin e Vendit për Kosovën 2024: analizë dhe rekomandime mbi fushat kryesore".

Dea Fetahu nga GLPS ka folur rreth rezultateve të dalta nga Raporti i Vendit për Kosovën 2024, i publikuar nga Komisioni Evropian më 30 tetor. Sipas saj, Kosova ka shënuar progres të mirë në katër fusha, njëfarë progresi është shënuar në 11 fusha, progres i limituar në 17 fusha dhe dy fusha kanë mbetur pa progres fare. "Ky raport përbën një ndër instrumentet kyçe që ne e përcjellim vlerësimin që i bëhet Kosovës nga Komisioni Evropian dhe duke parë rëndësinë e vlerësimit, GLPS-ja ka monitoruar këtë proces që nga viti 2012. Edhe në vitin 2024 raporti i progresit tregon se Kosova nuk ka arritur të shënojë ndonjë progres të mjaftueshëm e që do të konsiderohet si thelbësor për integrimin në BE. Po ashtu, ky

është raporti i parë që vjen për Kosovën. Këtë vit ka shënuar progres gjithsej në dy kapituj, që ka të bëjë me drejtësinë, sigurinë dhe lirinë, si dhe kapitulli për politikën sociale dhe punësimin. Kosova ka shënuar progres të mirë edhe në katër fusha, njëfarë progresi është shënuar në 11 fusha, progres i limituar në 17 fusha dhe dy fusha kanë mbetur pa progres fare", ka raportuar Fetahu.

Më tutje, ajo ka thënë se në këtë raport kritikë ka ndaj Kuvendit të Kosovës për mosfunksionimin e duhur. Sipas Raportit, thuhet se janë vërejtur ndarje politike ndërmjet pozitës dhe opozitës. "Raporti ka filluar me një kritikë ndaj Kuvendit të Kosovës për mosfunksionim të duhur për shkak të ndarjeve të vërtetshme politike në mes të pozitës dhe opozitës, dhe kjo ka minuar shumë procese legjislative dhe marrëveshje ndërkombëtare. GLPS-ja ka vërejtur që shumica e seancave në sezonin e vjeshtës janë anuluar dhe konsiderojmë



që nuk ka pasur përbushje aspak të kënaqshme të agjendës legjislative. Madje në raport thuhet se në këtë vit shihet se Qeveria e Kosovës vazhdon të mos marrë parasysht rekomandimet e BE-së. Fetahu theksoi se Raporti i

Progresit bëri thirrje në përsëritje të riemërimit të kryeprokurorit të shtetit. "Raporti i këtij viti ka theksuar qartazi se Qeveria e Kosovës vazhdon të mos marrë parasysht rekomandimet e BE-së në këtë fushë. Raporti rekomandon përmirësimin e tij si

dhe ndryshimin e një ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil. Raporti bën thirrje për përsëritje të shpejtë të procesit të riemërimit të kryeprokurorit të shtetit, i cili duhet të udhëhiqet me transparencë", ka thënë ajo.

## Shtetet e Bashkuara kritikojnë projektligjet e miratuara nga Serbia që lidhen me Kosovën

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Shtetet e Bashkuara kritikuan Qeverinë e Serbisë për shkak të miratimit të një projektligji mbi juridiksionin gjyqësor serb në Kosovë, për të cilin Bashkimi Evropian tha se përbën shkelje të detyrimeve të Beogradit që dalin nga procesi i bisedimeve në Bruksel. "Ne pajtohemi me BE-në...", shkroi të enjten zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Matthew Miller. "Kosova dhe Serbia duhet ta zbatojnë marrëveshjen e vitit 2023, përfshirë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe dhe zgjidhjet që dalin nga dialogu për të gjithë qytetarët, përfshirë serbët në Kosovë", shkroi ai.

Të mërkurën Bashkimi Evropian i bëri thirrje Serbisë t'i rishqyrtojë projektligjet e miratuara nga qeveria serbe të hënën, në të cilat e shpall Kosovën zonë të mbrojtjes së veçantë sociale dhe përcaktan,



siç thuhet, "kompetencën e autoriteteve gjyqësore serbe për ndjekjen e veprave penale të kryera në territorin e Kosovës".

Këto projektligje u paralajmëruan nga presidenti i Serbisë Aleksandar

Vuçiq më 13 shtator, si kundërpërgjigje ndaj vendimeve të autoriteteve të Kosovës për t'i shuar institucionet e emëruara nga Serbia. Projektligji për kompetencën e

autoriteteve gjyqësore, ndër të tjera, parasheh themelimin e një prokurorie të posaçme dhe një trupi gjyqësor të posaçëm "për t'i ndjekur penalisht të gjithë ata që marrin pjesë në përndjekjen e

popullatës serbe në Kosovë", nxitu reagime të ashpra të autoriteteve në Kosovë.

Kryeministri Albin Kurti tha se projektligjet e tilla janë veprime armiqësore dhe agresive ndaj kushtetutshmërisë dhe sigurisë në Kosovë. "Kërkojmë që në këtë pyetje të përgjigjen me saktësi dhe drejtësi faktorët ndërkombëtarë që na kanë ndihmuar aq shumë, por në të njëjtën kohë duhet të vazhdojnë të na mbështesin sepse Kosova si republikë në të cilën kanë kontribuar ata, sërish po sulmohet nga fqinji ynë verior", tha ai.

Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara po u bëjnë thirrje palëve t'i shmangin veprimet që mund të nxisin tensione dhe të përqendrohen në zbatimin e marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve, për të cilën palët ranë dakord vitin e kaluar në Bruksel dhe në Ohër.

## Ulen vlerat e manganit në Badovc, uji ende i papijshëm

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Vlerat e manganit në liqenin e Badovcit janë ulur ndjeshëm, por uji mbetet ende i papijshëm, ka konfirmuar Burbuqe Nushi - Latifi, udhëheqëse e Komisionit për Ujëra dhe koordinatorë në IKShPK. "I kemi marrë 15 monstra prej rrjetit të zonës e cila furnizohet nga Badovci. Vlerat janë më të ulëta sesa në ditët e mëhershme. Janë 0,2

deri në 0,4. Ka pasur vlera që kanë shkuar deri në 500 e 600. Standardi ligjor është 0,05 miligram për litër", ka thënë ajo në RTK.

Nushi-Latifi ka treguar se sivjet ky fenomen është lajmëruar më herët dhe po zgjat më shumë. Sipas saj, ndryshimet klimatike dhe infrastruktura e liqeve ndikon në rritjen e manganit. "Është fenomen që ndodh gjithkund gjatë

ndërrimeve sezonale. Pse po ndodh në liqenin e Badovcit është për shkak të infrastrukturës që ka, por secili liqen që është i destinuar për ujë të pijshëm e ka infrastrukturën asisoj që mund të ndërrohet niveli i përputhjes së ujit dhe përcjellja e tij në fabrikë. Te Badovci është vetëm në një vend dhe nuk ka mundësi të lëvizë me atë përthithje", ka sqaruar ajo.





# Nëse jo Kurti, kush duhet ta formojë Asociacionin?

Deklarimet rreth themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë morën sërish vëmendje të konsiderueshme këtë javë, pavarësisht se për të është diskutuar qindra herë që 11 vjet. Asociacioni u riaktualizua më 29 tetor, kur shefi i ekzekutivit të Kosovës, Albin Kurti, tha para medieve se si kryeministër i një republike demokratike nuk mund të formojë asociacione të komunave. Sipas njohësit të çështjeve politike, Agon Maliqi, Kurti si kryeministër nuk mund t'i ikë kësaj përgjegjësie

**PRISHTINË, 1 NËNTOR** - Çështja e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë është ndër temat e pakta për të cilën flitet gati çdo javë dhe që secilën herë bëhet lajm. Të gjithë kanë qëndrime për të dhe e komentojnë. Për të janë arritur marrëveshje e janë përpiluar propozime. Por, zgjidhja përfundimtare nuk është arritur kurrë.

Asociacioni u riaktualizua më 29 tetor, kur shefi i ekzekutivit të Kosovës, Albin Kurti, tha para medieve se si kryeministër i një republike demokratike nuk mund të formojë asociacione të komunave. “Komunat asociohen me njëra-tjetrën, koordinohen, bashkëpunojnë. Ju tashmë e dini që ne e kemi një Asociacion të Komunave të Kosovës. Nëse dikush e

dëshiron një asociacion tjetër, atëherë kjo duhet të vijë nga komunat... nëse kryeministri do të themelonte asociacion të komunave, ky do të ishte një imponim ndaj komunave”.

## Cila është rruga përpara?

Pavarësisht se Kurti i bëri këto deklarata, ai është përfshirë në të kaluarën në diskutimet për themelimin e Asociacionit. Sipas njohësit të çështjeve politike, Agon Maliqi, Kurti si kryeministër nuk mund t'i ikë kësaj përgjegjësie. “Mënyra se si do të krijohet Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe parashihet përmes Marrëveshjes mbi Asociacionin dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese - që si rrjedhojë

kanë krijuar detyrim politik, por edhe juridik për qeverinë për ta dërguar për shqyrtim statutin [e Asociacionit]”, tha Maliqi në disa përgjigje me shkrim për Radios Evropa e Lirë.

Maliqi konsideron se në këtë rast nuk bëhet fjalë për një asociacion sikurse ai ekzistues i komunave, “por një trup të modelit të ri dhe me kompetenca shtesë, që duhet t'i shtohet rendit juridik e që, për rrjedhojë, kërkon rregullim dhe përfshirje të të gjitha niveleve ekzistuese të pushtetit”.

Ndërkaq Toby Vogel nga Këshilli për Politikën e Demokratizimit në Bruksel i tha Radios Evropa e Lirë se deklarata e kryeministrit të Kosovës është e pasinqertë. Sipas tij, “i ka takuar gjithmonë Prishtinës t'i krijojë kushtet për formimin e Asociacionit, por gjithmonë sipas një konteksti të caktuar”. “Kosova vazhdon të jetë nën masa të Bashkimit Evropian, derisa Serbia nuk është përballur me asnjë pasojë për Banjskën, apo për refuzim të Marrëveshjes së Ohrit. Pse, atëherë, Kurti do ta ndryshonte pozitën e tij në këtë situatë? Nuk ekziston ndonjë përfitim zgjedhor apo diplomatik për të, nëse pranon ta formojë Asociacionin”.

## Historiku i Asociacionit

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për formimin e Asociacionit më 2013 dhe një tjetër marrëveshje për parimet më 2015. Por, Qeveria e Kosovës refuzon të formojë, siç thotë, asociacion njëetnik, ndërsa Serbia insiston për zbatimin e marrëveshjes. Më 2015 Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka vlerësuar se marrëveshja për parimet nuk është në përputhje me Kushtetutën në 23 pika të saj, ndonëse ato mund të harmonizohen.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian insistojnë vazhdimisht që Kosova ta dërgojë në Gjykatën Kushtetuese një draft-statut për Asociacionin, të cilin e paraqiti Perëndimi në tetor të vitit të kaluar.

E pyetur për ta komentuar deklaratën e Kurtit, zëdhënësjë e Bashkimit Evropian, Nabila Massrali, i tha Radios Evropa e Lirë se themelimi i Asociacionit është obligim ligjor për Kosovën, sipas të drejtës ndërkombëtare. Sipas saj, fakti që marrëveshjet për Asociacionin janë arritur në kuadër të dialogut, “nënkupton që secili propozim duhet të diskutohet me

Serbinë dhe ndërmjetësuesin e BE-së”.

Edhe në Raportin e Progresit të BE-së për Kosovën, mungesa e hapave drejt themelimit të Asociacionit është përmendur si pengesë në procesin e normalizimit mes vendeve fqinje.

Departamenti amerikan i Shtetit i ka thënë Radios Evropa e Lirë se dialogu i Brukselit ka ofruar zgjidhje praktike, “të cilat do t'i promovojnë të drejtat e të gjithë shtetasve të Kosovës, përfshirë ato të serbëve në veri të Kosovës”, prandaj ka bërë thirrje për zbatim të marrëveshjeve, përfshirë atë për Asociacionin.

Radio Evropa e Lirë kërkoi nga Qeveria e Kosovës ta sqarojë më tepër qëndrimin e Kurtit, por nuk mori përgjigje.

## Prioritet: Marrëveshja Bazë

Në deklarinimin para gazetarëve, Kurti ka insistuar në nënshkrimin e Marrëveshjes Bazë - referencë për një marrëveshje për normalizim marrëdhëniesh, të arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë më 2023. Në një pikë të saj, ajo parasheh që

# Zgjedhjet për Shtëpinë e Bardhë, Harris dhe Trumpi shtojnë fushatat

WASHINGTON, 1 NËNTOR - Kanë mbetur pesë ditë nga zgjedhjet për Shtëpinë e Bardhë. Kandidatja demokrate Kamala Harris dhe rivali i saj republikan, Donald Trump, kanë shtuar fushatat dhe sulmet e ndërsjella. Fushata e demokrates Harris ka hasur vështirësi që ta shtojë mbështetjen mes votuesve meshkuj, ndërsa komentet e republikanit Trump për gratë kanë shtuar hendekun e mbështetjes për të.

Gjatë një tubimi të enjten në Arizona, demokratja Harris tha se komenti i kundërshtarit të saj se do t'i mbrojë gratë, pavarësisht nëse do t'u "pëlqejë atyre apo jo", tregon se kandidati republikan për president nuk i kupton të drejtat e grave "për të marrë vendime për jetën, përfshirë edhe trupin e tyre". "Unë mendoj se është fyese për

të gjithë, meqë ra fjala", tha Harris përpara se t'i niste fushatat në shtetet e pavendosura të Arizonës dhe Nevadës.

Gjatë një tubimi në Feniks të Arizonës, Harris tha se kundërshtari i saj: "Nuk e respekton lirinë apo mençurinë e grave për të vendosur për gjërat që u interesojnë atyre dhe për të marrë vendime në përputhje me rrethanat. Ne kemi besim te gratë".

Komentet e Trumpit vijnë ndërsa ai ka ndeshur vështirësi për ta rritur mbështetjen mes votueseve.

Kandidati republikan për president flet në përgjithësi për mbrojtjen e grave nga kriminelët, terroristët dhe elementët e huaj, që përputhet me tablonë e zymtë të një vendi në rënie, siç e cilëson ai Amerikën. "Unë do t'i

mbroj nga emigrantët që vijnë. Unë do t'i mbroj nga vendet e huaja që duan të na godasin me raketa dhe shumë gjëra të tjera", u shpreh Trumpi në një tubim në Green Bay të shtetit Uiskonsin.

Sipas të dhënave nga firma analitike "Target Smart", rreth 1.2 milion gra më shumë se burra kanë marrë pjesë në votimet e hershme në shtatë shtete që cilësohen si fushëbetë.

Ndalesat e fundit të Harrisit mbrëmjen e së enjtes ishin qytetet Las Vegas dhe Reno të Nevadës, një shtet fushëbetë.

Mbrëmjen e së enjtes, ish-presidenti Donald Trump zhvilloi një tubim në qytetin Albuquerque të shtetit New Mexico, ndërsa ka në plan të ndalojë në Salem të Virxhinias të shtunën.

Ekipi i fushatës së republikanit

Trump thotë se është optimist bazuar pjesërisht te pjesëmarrja në votimet e hershme. Drejtuesit e fushatës thonë se ka gjasa që republikani Trump të fitojë në shtetet New Mexico dhe Virxhinia. Hera e fundit që këto shtete votuan për një kandidat republikan për Shtëpinë e Bardhë është në vitin 2004 për presidentin George W. Bush.


Kandidatët e dy kampeve kundërshtarë kanë zhvilluar tubime të shumta në shtetet në fushëbetë, me 21 tubime në Pensilvani, 17 në Miçigan dhe 13 në Karolinën e Veriut.

Ndërkohë kandidati republikan për president, Donald Trump, ngriti padi të enjten kundër kanalit televiziv CBS News, lidhur me një intervistë të rivalës së tij demokrate të transmetuar në emisionin "60 Minutës" në

fillim të tetorit, për të cilën pretendon se ishte manipuluar, sipas dokumenteve të depozituara në gjykatë.

Aktipadia pretendon se rrjeti CBS transmetoi dy përgjigje të ndryshme nga kandidatja Harris për një pyetje në lidhje me luftën e Izraelit kundër Hamasit në Gazë. "Pretendimet e përsëritura nga ish-presidenti Trump janë të rreme", tha një zëdhënës i rrjetit CBS. "Padia e ngritur nga Trumpi kundër rrjetit CBS është krejtësisht e pabazë dhe do të mbrohemi fuqishëm kundër saj".

Demokratja Harris dhe republikani Trump janë në një garë shumë të ngushtë, ndërsa në ditët e fundit po përpiqen t'i bëjnë për vete ata që mund të jenë ende të pavendosur dhe për ta mobilizuar pjesëmarrjen në votime të bazës së tyre.



komunitetit serb në Kosovë t'i ofrohet një nivel i caktuar i vetëmenaxhimit.

Agon Maliqi beson se pa e dërguar Kosova draft-statutin për Asociacionin në Gjykatën Kushtetuese, "vështirë se mund t'i shohë përfitimet e parapara nga marrëveshjet e Brukselit dhe Ohrit".

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka kërkuar garanci të sigurisë nëse ndërkombëtarët

insistojnë në formim të Asociacionit, edhe pas "tërheqjes së Serbisë nga Marrëveshja Bazë".

I dërguari evropian për dialogun, Miroslav Lajçak, ka deklaruar se Serbia e ka tërhequr letrën e nisur nga ish-kryeministrja Ana Bërnabiq, me të cilën kishte dalë kundër Marrëveshjes Bazë. Vetë Serbia nuk është deklaruar publikisht.

## "Manovra për heqje të presionit para zgjedhjeve"

Kosova do t'i mbajë zgjedhjet e ardhshme parlamentare më 9 shkurt 2025.

Jo pakkush i ka parë deklaratat e bëra së fundmi për Asociacionin si zvarritje të temës deri pas zgjedhjeve. Agon Maliqi në mesin e tyre. "Deklaratat e

kryeministrit i shoh si, thjesht, manovra të përkohshme për heqje të presionit para zgjedhjeve".

Toby Vogel, ndërkaq, paralajmëroi për presion të shtuar ndaj qeverisë së radhës. Sipas tij, nëse Kurti i fiton zgjedhjet, "nuk do të mundet pafundësisht të paraqesë arsye të reja pse nuk mund të formohet Asociacioni".

Ai tha se më e rrugës do të ishte nëse Kurti do t'ua sqaronte

komuniteteve pse në situatën aktuale disa marrëveshje të dialogut kanë mbetur pezull dhe që njëkohësisht Kosova t'ua bëjë të qartë partnerëve që edhe Serbia duhet të mbahet përgjegjëse për veprimet e veta. "Gjithë procesi duhet të zbllokohet, jo vetëm ngërçi për Asociacionin", theksoi ai. Duke e parë situatën aktuale, Vogel vlerësoi se zor që mund të merret dikush me Asociacionin menjëherë pas zgjedhjeve.

# Botohet libri “Ushtria Çlirimtare e Kosovës” i autorit Bardhyl Mahmuti

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Sot, në vigël të 35-vjetorit të Epopesë së “Kodres së Diellit”, kur rënia heroike e Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut paralajmëroi hyrjen në fazën e luftës çlirimtare, ka dalë nga shtypi libri “Ushtria Çlirimtare e Kosovës në shënjestër të vazhdueshme” i autorit Bardhyl Mahmuti.

## NGA FITORJA DIPLOMATIKE E UÇK-SË TE GJYKATA E HAGËS

Përpara vendosjes së kontakteve diplomatike të përfaqësuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me diplomatët amerikanë, aksionet e saj kundër forcave të armatosura dhe pjesëtarëve të aparateve represive serbe cilësoheshin si “akte terroriste” nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara dhe, rrjedhimisht, nga shtetet më të fuqishme të skenës politike ndërkombëtare.

- Për cilat takime bëhet fjalë dhe kush e përfaqësoi UÇK-në?

- Si u organizuan takimet dhe cili ishte roli i shtetit shqiptar?

- Cilat tema u trajtuan gjatë bisedimeve dhe si u realizua fitorja diplomatike e UÇK-së?

- Cili ishte roli i Qeverisë së Përkohshme gjatë periudhës përfundimtare të luftës në Kosovë dhe përse mungesa e konsensusit politik e la Kosovën pa institucione të përkohshme drejtuese?

- Si e shfrytëzoi Serbia mungesën e aktivitetit diplomatik të Kosovës për të përhapur imazhin negativ për UÇK-në dhe si u sajua gënjeshtër për “trafikim organesh njerëzore gjatë luftës në Kosovë”?

- Përse u mobilizuan Carla Del Ponte dhe Dick Marty pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës? - Kush ishin hartuesit e raportit që përveçsoi Dick Marty dhe cila ishte prapavija e tij?

- Si u sajua shprehja “Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët” dhe përse aktakuza e ngritur kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit vë në bankën e akuzës luftën çlirimtare të popullit shqiptar të Kosovës?

Nëpërmjet bashkëbisedimit me Muhamet Mavrajn, kryetar i atëhershëm i Kuvendit të Unionit të Pavarur të Studentëve të Prishtinës dhe kryeredaktor i gazetës së Universitetit “Bota e re”, Bardhyl Mahmuti, drejtues i Grupit Diplomatik të UÇK-së, për



herë të parë shpalos thelbin e atyre bisedimeve, ku fati i ardhmërisë së luftës sonë ecte nëpër të shpatës!

Ramadan Avdiu  
(Përfaqësues i Grupit Diplomatik të UÇK-së)

## Ku mund ta gjeni librin?

Në Kosovë lexuesit e interesuar mund ta gjejnë në zyrat e gazetës “Epoka e re”, që është botuese e librit, në adresën: Sheshi “Nëna

Tereza”, rr. “Edit Durham” nr. 45, Prishtinë. Ndërkaq lexuesit që jetojnë në shtetet e demokracive perëndimore, librin mund ta sigurojnë nëpërmjet Qendrës “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur”, <https://kosovogencide.com/>

# Mungojnë biokimistët, analizat i lexojnë infermierët

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Në sistemin shëndetësor të Kosovës vazhdon një krizë e cila kërcënon cilësinë e kujdesit që u ofrohet pacientëve. Spitali i Përgjithshëm në Vushtri dhe ai në Ferizaj ka rreth tre vjet që funksionojnë pa biokimistë. Për pasojë, analizat laboratorike, të cilat janë kritike për diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve të ndryshme, lexohen nga stafi i infermierëve dhe teknikëve, që ngre shqetësime për saktësinë dhe besueshmërinë e tyre.

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK), i cili mbikëqyr spitalet rajonale, thotë se ka shpallur disa konkurse për specialistë të biokimisë, por interesimi i tyre mbetet i ulët.

Institucionet publike shëndetësore në Kosovë nuk kalojnë nëpër ndonjë procedurë licencimi - kur themelohen, ato sigurohen se i plotësojnë kriteret me staf dhe pajisje, për të funksionuar si të tilla.

## Spitali i Vushtrrisë, pa biokimist nga viti 2022

Në Vushtri, drejtoresha e Spitalit të Përgjithshëm, Shefkije Shatri, thotë se mungesa e biokimistit e vështirëson mbarëvajtjen e punëve. “Deri në vitin 2022 i kemi pasur dy biokimistë. Nga ajo kohë nuk kemi. Janë hapur konkurse, por ende nuk ka”, thotë

ajo. Në mungesë të tyre, Shatri thotë se rezultatet e analizave në këtë spital i kontrollon shefi kryesor i laboratorit, i cili, siç thotë, “është infermier me përvojë 20-vjeçare”. “Unë nuk e di a ka të drejtë t’i lexojë analizat ai, sepse nuk jam e thirrur për këtë, por mund të them se ne vuajmë për një biokimist që nuk e kemi”, thotë Shatri për Radion Evropa e Lirë. Ajo tregon se në vitet e fundit janë shpallur disa konkurse për pozitën e biokimistit, por se “nuk ka pasur të interesuar”. “Ata po joshen më shumë nga sistemi privat”, sipas saj.

Në spitalin që udhëheq Shatri në Vushtri - komunë me rreth 61 000 banorë - bëhen më shumë se njëqind analiza brenda ditës. Kushtet e punës në laboratorin kryesor, sipas stafit, janë të mira dhe aparatúra është e re.

## Spitali i Ferizajt, pa biokimist për më shumë se tre vjet

Situatë pothuajse e njëjtë është edhe në Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajt - komunë me rreth 105 000 banorë. Për më shumë se tre vjet ky spital funksionon pa biokimist. “Diku nga viti 2020/2021, spitali është pa biokimist”, thotë për Radion Evropa e Lirë ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të spitalit, Fikret Arifi. “Para disa



ditësh kanë ardhur punëtorë të rinj - në mesin e tyre edhe biokimistja, e cila tash ka shkuar në pushim të lehonisë. Tani në proces të rekrutimit kemi edhe një biokimist tjetër”, shton Arifi. Ai tregon se ka autorizuar një mjek internist-reumatolog, i cili monitoron punën në laborator porse, sërish, punën kryesore rreth analizave e bëjnë laborantët. Sipas statistikave të spitalit, shërbime për analiza aty kërkojnë mbi dy mijë pacientë në muaj.

## Mungesa edhe në Spitalin e Mitrovicës së Jugut

Në Spitalin e Përgjithshëm të Mitrovicës së Jugut punon vetëm një biokimist - jashtë orarit të saj, analizat i lexon stafi ndihmues. Drejtori mjekësor, Gëzim Berisha, thotë se spitali ka nevojë për më shumë biokimistë, pasi aty kryhen mbi 200 analiza në ditë. “Ne në konkursin e fundit kemi kërkuar edhe një biokimist

shtesë, por nuk ka aplikuar askush”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë. “Kur biokimistja nuk është në punë, analizat i lexojmë bashkë me laborantë, e shpesh edhe me doktoreshën, edhe pse është jashtë orarit të punës”, thotë Berisha.

## Rëndësia e biokimistëve

Profesionistët shëndetësorë thonë se puna e biokimistëve është thelbësore për trajtimet mjekësore si dhe për përmirësimin e metodave të diagnostikimit dhe trajtimit të sëmundjeve.

Profesoresha Valdete Topçiu-Shufta, specialiste e biokimisë, thotë për Radion Evropa e Lirë se jo vetëm laborantët në spitalet, por edhe ata në shtëpi të shëndetit duhet të kenë së paku një biokimist të specializuar, i cili i bën të vlefshme analizat e bëra - përndryshe ka rrezik që leximi i tyre të mos jetë i saktë.

“Rezultati duhet të kontrollohet nga dora e mjekut, e specialistit, përpara se të lëshohet. [E nëse nuk ka biokimist], kjo çështje i takon Ministrisë [së Shëndetësisë] që ta rregullojë”, thotë Topçiu-Shufta. Të kontaktuar nga Radio Evropa e Lirë, zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë thonë se çdo spital i përgjithshëm apo special, është i obliguar ta ketë laboratorin biokimik-hematologjik, e bashkë me të edhe profesionistin e lëmit

shëndetësor. Për rastet konkrete në Ferizaj e Vushtri nuk japin komente. Në ShSKUK thonë se ky institucion ka shpallur disa herë konkurse për pranimin e mjekëve specialistë - në mesin e tyre edhe biokimistë. “Në disa spitalet janë plotësuar këto pozita, përderisa në rastet e tjera nuk ka pasur të interesuar”, thuhet në një deklaratë me shkrim të Drejtorisë së ShSKUK-së dërguar Radios Evropa e Lirë.

Aty theksohet, po ashtu, se në kuadër të planit të tyre për shërbimet e biokimisë, gjatë vitit të ardhshëm parashihet të ketë riorganizim në të gjithë laborantët që menaxhohen nga ShSKUK-ja.

Rreth 20 specialistë të biokimisë janë duke kryer shkollimin në këtë lëmë dhe, në vitin ardhshëm, pritet të shërbejnë edhe në institucione publike, sipas ShSKUK-së. Por, kjo mungesë nuk është e izoluar vetëm te biokimistët.

Institucionet publike të kujdesit shëndetësor në Kosovë përballen me mungesa të specialistëve edhe në fusha të tjera kritike, veçanërisht anesteziologë.

Paga mesatare e një mjeku specialist në Kosovë është rreth 1 200 euro.

Klinikat private me paga më të larta dhe kushte më të mira të punës janë shpesh opsion më tërheqës për specialistët shëndetësorë.

## 117 aktakuza kundër 143 personave për 24 orë

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Prokurori i Shtetit ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit nga prokuroritë themelore janë ngritur njëqind

e shtatëmbëdhjetë (117) aktakuza kundër njëqind e dyzet e tre (143) personave për kryerjen e veprave të

ndryshme penale. Po ashtu, me urdhër të Prokurorit të Shtetit janë ndaluar nëntëmbëdhjetë (19) persona

si dhe janë paraqitur katër (4) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit ndaj katër (4) personave.



Reagim i KMDLNj-së

# A po bëhet Kosova shoqëri e kontrolluar nga parapolitika brenda institucioneve?

Nëpër media po qarkullon lajmi se gazetari Vehbi Kajtazi i është vënë një mjet në automobilin e tij, deri tash nuk dihet nga kush dhe për çka shërben. Gjithashtu ishte një informatë se gazetaret Ilir Mirena, Berat Buzhala, Vehbi Kajtazi, Lirim Mehmetaj dhe të tjerë po përcillen nga një strukturë brenda AKI-së e që nuk i raportuaka shefit të AKU-së por shefit të parapolitikës, Dejana Mihali. Kjo u përgënjeshtroi nga shefi i AKI-së gjatë një përpjekje për të raportuar para Komisionit parlamentar për Mbikëqyrje të AKI-së, në rrethana të tensioneve dhe kërcënimeve. Prokuroria Themelore në Prishtinë mohoi se po hetohen

gazetarët Lirim Mehmetaj dhe Vehbi Kajtazi por se vetëm po mblidhen informata. Në anën tjetër punësimet në baza politike, partiake dhe nepotiste kanë hyrë në kriminalitet të thellë duke shkelur të drejtat elementare të njeriut, barazi gjatë konkurrimit dhe respektim të konkursit. Tash, ky veprim kriminal as që po bëhet në mënyrë të fshehtë, kombinimet për punësim po bëhen haptazi sikur që ndodhi, gjithnjë sipas raportimeve të mediave në MPJD dhe Ministri të Bujqësisë, ministrat e të cilave janë bashkëdrejtues të një subjekti politik të pozitës. KMDLNj kërkon nga Prokuroria e shtetit të bëjë hetime për këto



dyshime që rëndë shkelin të drejtat e njeriut sikur që e shkelin dhe dhunojnë institucionin e konkursit. Përcjellja e qytetarëve të Kosovës dhe të tjerëve bëhet vetëm me urdhër të gjykatës e jo të individëve që e keqpërdorin

besimin e dhënë nga qytetarët për qëllime politike dhe partiake. Edhe raporti i fundit i Progresit qartazi e thotë se ndaj gazetarëve që nuk i binden regjimit po ushtrohet presion përmes kërcënimeve në përpjekje të

pengojnë punën e tyre. Gjithashtu, presioni ndaj Prokurorisë dhe Gjykatave po merr karakter të linçimit publik përmes ndërhyrjeve flagrante të pushtetit, në përgjithësi dhe MD në veçanti. Të drejtat e njeriut nuk mund të zbatohen sipas standardeve të dyfishte ku, në vend të dokumenteve ndërkombëtare dhe kombëtare për këto të drejta, si standard mbisundon përcaktimi politik dhe partiak. Në prag të zgjedhjeve po krijohet një situatë e tensionuar, me një fjalor të ashpër dhe toksik që e rrezikon mbarëvajtjen e zgjedhjeve prandaj ligji duhet të veprojë ndaj të gjithëve që e promovojnë dhe zbatojnë fjalorin e urrejtjes.

## Haradinaj takon ambasadorin amerikan, konfirmon angazhimin për anëtarësimin direkt të Kosovës në NATO

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Ramush Haradinaj, kandidat për kryeministër i koalicionit AAK-Nisma-Konservatorët-E30, zhvilloi një takim me ambasadorin amerikan Jeffrey Hovenier në Ambasadën e ShBA-së në Prishtinë.

Gjatë takimit u diskutuan zhvillimet politike dhe të sigurisë në Kosovë, me fokus të veçantë në përpjekjet për anëtarësim direkt në NATO. Ish-kryeministri i Kosovës e siguroi ambasadorin Hovenier se aktivitetet politike të koalicionit do të përqendrohen në këtë synim të përbashkët. "Plani aksional për anëtarësim në NATO mbetet objektivi ynë strategjik si perspektiva e vetme për të siguruar paqe dhe siguri afatgjatë për vendin dhe rajonin



tonë", ka deklaruar Haradinaj pas takimit. Gjatë bisedës Haradinaj shprehu mirënjohje të thellë ndaj ambasadorit dhe Shteteve të Bashkuara për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Kosovës. "E sigurova ambasadorin Hovenier

se do të angazhohemi që aktivitetet tona politike të jenë të përqendruara në këtë synim të përbashkët", shtoi kandidati për kryeministër, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit me aleatët ndërkombëtarë në rrugën drejt NATO-s.

## Buxheti i FSK-së për vitin 2025, 208 milionë euro, LV-ja kritikon qeveritë e kaluara

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Me ardhjen e qeverisë Kurti buxheti për ushtrinë është rritur, duke dëshmuar përkushtimin dhe prioritetin që i jepet sigurisë - një fushë jashtëzakonisht e rëndësishme sot, veçanërisht për Republikën e Kosovës, ka njoftuar LV-ja. "Një krahasim i thjeshtë midis ndarjeve

buxhetore të vitit 2021 dhe atyre të vitit 2025 tregon qartazi ndryshimin e madh në qasjen ndaj ushtrisë. Më parë, gjatë qeverisjes së Klubit të Stërvjetëruar Politik, ushtria nuk merrte vëmendjen e duhur, siç dëshmojnë rekrutimet e pakta, pajisjet ushtarake të

vjetruara dhe buxheti i ulët. Sot kjo gjendje ka ndryshuar drastikisht me qeverinë e drejtuar nga Lëvizja Vetëvendosje. Janë bërë investime të mëdha në rritjen e numrit të ushtarëve, modernizimin e pajisjeve ushtarake dhe blerjen e sistemeve më të reja të armatimit", ka njoftuar LV-ja.



## Murati: Lajmet e rreme nuk kalojnë, shpenzimet për karburante janë 10 milionë euro, e jo 31

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka demantuar raportimet për shpenzimet e karburantit për automjetet për vitin 2023. Përmes një postimi në "Facebook", ai ka thënë se shpenzimet totale janë 10 milionë euro e jo 31 milionë euro siç është raportuar. "Lajmet e rreme nuk kalojnë! Shpenzimi i karburantit për automjete për vitin 2023, për

nivelin qendror dhe atë lokal, është 10.47 milionë euro. Kjo është e faktuar edhe në raportin vjetor financiar të miratuar e dorëzuar në Kuvend. Duhet theksuar se shumica e këtij shpenzimi shkon për flotën e automjeteve të policisë dhe të FSK-së. Raportimet se shpenzimi për karburante të veturave për vitin 2023 është 31 milionë euro është i

pavërtetë, dhe i pasaktë. Shifra prej 31 milionë euro që është përmendur nga Raporti Vjetor i Auditimit mund të jetë përmbledhje që përmban edhe shumata që janë shpenzuar për naftë për ngrohje, ose dru zjarri për ngrohje, por nuk ka të bëjë me shifrën faktike që është shpenzuar për karburant për automjete", ka shkruar ministri Murati.



## Rizvanolli njofton se do të investojnë në 22 ndërtesa sociale në disa komuna të Kosovës

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Ministri e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka njoftuar se do të investojnë në ndërtesat sociale ku jetojnë familjet në nevojë.

Investimet do të bëhen në Prishtinë, Skenderaj, Klinë, Drenas, Gjilan, Viti, Kamenicë, Obiliq, Istog, Malishevë. "785 familje në nevojë (rreth 3,400 qytetarë) do të kenë kushte më të mira

jete se pasi 22 banesa sociale ku jetojnë, përmes investimit prej 5.5 milionë euro do të kenë: Izolimim e kulmit; Izolimim e mureve; Dyer e dritare të reja; Sistemin e ngrohjes për secilën familje; Renovimin e hyrjeve; Sistemin e interfonisë dhe masat për mbrojtje kundër zjarrit dhe detektorët e tymit", thuhet në njoftimin e bërë nga ministrja.

Ndër të tjera, ajo ka shtuar se "nga të gjitha projektet e investimeve që janë bërë gjatë këtij mandati, e që po nisim këtë mandat që të bëhen përgjatë viteve në sektorin e energjisë, për mua ky është më i veçanti sepse prek direkt shtresat e cënueshme të shoqërisë - të cilat kurrë më herët nuk janë trajtuar me kujdesin e duhur".



## Richard Record: Shqipëria dhe Kosova të përqendrohen në diversifikimin e ekonomive të tyre

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Në raportin e fundit për gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor, Banka Botërore parashikon rritje të moderuar ekonomike në dy vitet e ardhshme, por paralajmëron se rajoni vazhdon të mbetet i brishtë dhe rritja e tij ekonomike e pasigurt.

Në një intervistë për "Zërin e Amerikës", eksperti kryesor i Bankës Botërore për rajonin, Richard Record, tha se sfidat më të mëdha për Shqipërinë dhe Kosovën janë strukturore - çështjet si dallime në cilësinë e aftësive të forcës së punës, shpërputhja mes sektorit arsimor dhe nevojave të sektorit privat, si dhe sigurimi i investimeve cilësore, që do të siguronin vende pune më të qëndrueshme. "Ne jemi optimistë, por edhe të kujdesshëm sa i

përket mundësive për rritjen ekonomike të Ballkanit Perëndimor. Kemi parë një forcim të shkallës së rritjes. Rajoni në tërësi ka shënuar një rritje nga 2.6 për qind vitin e kaluar në 3.3 për qind këtë vit. Është e rëndësishme të kuptojmë se kjo po ndodh në një mjedis me shumë sfida dhe me shumë pasiguri nga jashtë. Bashkimi Evropian, në veçanti Gjermania, që është partnerja më e madhe tregtare dhe për investimet në tërë rajonin, ka tani një gjendje të pandryshuar e, ndoshta, ekonomia e saj është në recesion. Mes kaq shumë paqëndrueshmëri në mjedisin e jashtëm, fakti që rajoni po përjeton rritje me shkallë të përshpejtuar ekonomike, është shumë inkurajuese. Dhe natyrisht, fakti që Ballkani Perëndimor ka



rritje më të shpejtë se Bashkimi Evropian, nënkupton një shkallë përafrimi sa i përket standardit të

jetesës", ka theksuar Record. Ai ka shtuar se për ekonomi të vogla të hapura siç janë ato të

Kosovës dhe Shqipërisë diversifikimi është i rëndësishëm. "Kjo do të thotë ta baraspeshojnë kërkesën e jashtme me atë të brendshme, të sigurojnë një baraspeshë sa iu përket sektorëve të ekonomisë, për shembull të kenë mallra për të tregtuar si dhe shërbime, turizëm dhe aktivitete që lidhen me të. Kemi parë që përkundër rritjes mjaft të dobët në eurozonë, ka pasur rritje të fuqishme në sektorin e shërbimeve, të dërgesave nga diaspora si dhe turizmit. Këtu qeveritë mund ta luajnë rolin e tyre dhe, mbase, nuk është rastësi që këtë vit dhe në vitin e ardhshëm dy qeveritë, në Kosovë dhe në Shqipëri, po rrisin investimet publike në përpjekje për ta mbështetur rritjen ekonomike", ka deklaruar Record.

## Investimet e huaja direkte nga Zvicra në Kosovë në katër vitet e fundit janë rritur rreth 170 për qind



CYRRI, 1 NËNTOR - Takimet bilaterale në Zvicër të kryeministrit Albin Kurti nisën me shkëmbimin dhe bisedën me këshilltarin federal të Zvicrës dhe kryesuesin e Departamentit për Çështje Ekonomike, të Arsimit dhe Hulumentit, Guy Parmelin. Kosova dhe Zvicra kanë marrëdhënie të shkëlqyera me diasporën tonë si urë lidhëse dhe faktor i rëndësishëm i bashkëpunimit të ngushtë mes dy vendeve tona. Kryeministri shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme

të Zvicrës dhe theksoi rëndësinë e thellimit edhe më tej të marrëdhënieve tona. Ai shtoi se bashkëpunimi ynë ekonomik dhe tregtar po shtohet çdo vit, gjersa niveli i përgjithshëm i investimeve të huaja direkte nga Zvicra në Kosovë në katër vitet e fundit është rritur rreth 170 %. Ai nënvizoi edhe rritjen e eksporteve nga Kosova drejt Zvicrës, ku në të njëjtën periudhë kohore eksportet gati janë dyfishuar dhe përfshijnë një shumëllojshmëri produktesh si metale, produkte minerale,

ushqime, plastikë, gomë, makineri, pajisje, materiale elektrike dhe tekstile. Zvicra është tashmë destinacioni i pestë më i madh për mallrat e Kosovës. Në takim u theksua fakti se Kosova ka arritur Marrëveshjeve për Tregti të Lirë me vendet anëtare të EFTA-s, pjesë e së cilës është edhe Zvicra. Kosova është i vetmi vend në rajon që, përveç negociimit për tregti të mallrave, ka negociuar edhe për tregti të shërbimeve me vendet EFTA-n, duke shtuar kështu korpusin e mundësive për shkëmbime dhe bashkëpunim.

## Qeveria ndan mjete buxhetore për pagat dhe shtesat për komunën e Vitisë dhe të Kamenicës

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Qeveria e Kosovës ka ndarë mjete buxhetore për mbulimin e mungesës së mjeteve financiare në kategorinë e shpenzimeve paga dhe shtesa për komunën Kamenicë dhe

Viti. Në një mbledhje elektronike, ekzekutivi ka aprovuar ndarjen e mjeteve buxhetore për mbulimin e mungesës së mjeteve në kategorinë e shpenzimeve paga dhe shtesa

për komunën Kamenicë dhe Viti për muajin tetor 2024. "Qeveria e Republikës së Kosovës ka zhvilluar një mbledhje elektronike në të cilën ka aprovuar ndarjen e mjeteve buxhetore për

mbulimin e mungesës së mjeteve në kategorinë e shpenzimeve Paga dhe Shtesa për komunat Kamenicë dhe Viti, për muajin tetor 2024", thuhet në njoftimin e qeverisë.





# KAPJA E SHTETIT!



Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA

## Çka kapet, nuk çkapet

Kohë më parë, në shkrimin "Çkapja e shtetit" shkrova se VV bëri çdo gjë për të ardhur në pushtet me premtimin se do ta çkapë shtetin nga kapësit e "regjimit të vjetër," siç kanë dëshirë t'i quajnë ata që më herët ishin në pushtet. Realisht, kapësit e "regjimit të vjetër" e bënë shtetin duke e shpallur pavarësinë, siguruan mbi 110 njohje, ndërtuan infrastrukturën rrugore më të mirën në Ballkan, e konsoliduan administratën dhe ndërtuan themele të shëndosha mbi të cilat u ngritën superstrukturat tjera të shtetit, aspak më të dobëta se në shtetet tjera të rajonit. Të gjitha këto u arritën në kushte para pavarësisë dhe pas shpalljes së pavarësisë, që rreptësisht mbikëqyrej nga ndërkombëtarët, të cilët kishin kompetenca 100 për qind në hetimin e krimeve të luftës, krimeve me motive etnike, privatizimit, menaxhimit të resurseve energjetike, politikës së jashtme, doganave dhe Bankës Qendrore. Edhe në këto rrethana u arrit një konsolidim institucional, u bë një zgjidhje, jo në përputhje të plotë me nevojat për grupet e cenushme dhe u siguroi një mikrokonsolidim social.

## Premtime, premtime, premtime...

Kosova, si një vend gjysmë i shkatërruar nga lufta, nuk kishte mundësi t'i përmbushte të gjitha nevojat e qytetarëve, sikur që përballë me sfida politike gjatë bisedimeve me Serbinë, ku ndërkombëtarët mbanin qëndrim paternalist ndaj Serbisë. Prandaj, si domosdoshmëri e kohës ishte një lëvizje alternative. Kjo lëvizje fillimisht ishte KAN-i, si rrjet multietnik veprues e që udhëhiqej nga Albin Kurti që, pas kalimit të disa filtrave, nga një

lëvizje multietnike u shndërrua në një lëvizje hardpatriotike dhe nacionaliste, Lëvizja VETËVENDOSJE, që deklarativisht ishte kundër bisedimeve me Serbinë; fuqishëm ishin për bashkim kombëtar, flamurin kombëtar e kishin shndërruar në veshje "shpirtërore" dhe fizike, ishin kundër korrupsionit, nepotizmit partiak dhe familjarë me një slogan të fuqishëm dhe tundues: "Me hajna, me hajna, nuk ka shtet...". Ky slogan nuk mund të refuzohej nga askush. Qeveria Kurti 1 nuk e pati gjatë; u shkarkua me angazhimin kuptimplotë të Grenellit, në kohën e pandemisë së COVID-19. Këtë shkarkim e pata quajtur si një veprim jashtëzakonisht të pamoralshëm, duke thënë se në zgjedhjet e ardhshme VV do të fitojë bindshëm. Në zgjedhjet e shkurtit 2021, VV, bashkë me Listën Guxo të mercenares Vjosa Osmani dhe Alternativën që udhëhiqej nga zemlakja e Milan Radoiçiqit, Mimoza Kusari, fituan mbi 50 për qind të votave, duke siguruar pushtet absolut, bashkë me pakicat joserbe dhe koalicionin qeverisës nën hije, Listën Serbe. Duket se bashkëpunimi më i sigurt, më i sinqertë dhe më i afërt në aspektin e vendimmarrjes ishte ai me LS, ku Mimoza ishte sekse midis pushtetit real që udhëhiqej nga Albin Kurti dhe pushtetit nën hije që udhëhiqej nga Milan Radoiçiqi. Të gjithë shpresonim se ishte koha, nevoja dhe mundësia për ndryshime që premtonte Albin Kurti. Kur u formua kabineti qeveritar, u pa se nuk do të ketë gjë prej ndryshimeve, sepse ministrat e propozuar nuk kishin integritet profesional, kapacitet njerëzor, politik dhe moral të bëjnë ndryshime. Ndërkaq, për atë që bënin zhurmë më së shumti, kombëtares, kishin më së shumti mungesa; në vend të atij kombëtar, u përcaktuan për nostalgjikët jugosllavë dhe serbë.

Në vend se ta luftojnë korrupsionin, u shndërruan në mega hajdutë të veshur me rrobat e Robin Hudit. Në vend se të angazhojnë profesionistë të fushës, angazhuan leshko dhe servilë. Në vend se ta luftojnë nepotizmin familjar dhe partiak, nuk lanë anëtarë të partisë pa punësuar, që nga Lidhja Komuniste e Jugosllavisë dhe Serbisë e deri te të gjithë anëtarët e VV-së; nuk mbeti asnjë anëtar i familjeve të tyre pa u punësuar. Familjet që qençe i kishin shërbyer Jugosllavisë dhe Serbisë u punësuan në segmentet më të ndjeshme të shtetit, nga AKI-ja e deri te Akademia e Shkencave. Ky pushtet përdoqi vlerat e luftës, derisa i dërgoi në Hagë. Manipuloi me familjet, anëtarët e të cilave kishin dhënë çdo gjë për lirinë e Kosovës dhe bashkimin kombëtar. Disave mirë ua bëri; u treguan grykës dhe përfitues të sakrificave të familjes.

## Kjo qeveri pati shumë mundësi, i shpërdoroi të gjitha

Nuk kishte qeveri me mundësi më të mëdha për të bërë ndryshime se kjo. Kishte thuarje konsensus të votuesve për ndryshime. Kishte, pa asnjë dyshim, edhe konsensus të opozitës që të mos e pengojë qeverinë në realizimin e programit dhe premtimeve. Kishte përkrahje nga ndërkombëtarët, sidomos nga gjermanët, francezët dhe anglezët. Dhe, çka bëri kjo qeveri? Asgjë që kishte premtuar për të ardhur në pushtet. Ishte kopje anemike e qeverive të mëparshme që shpërdoroi çdo gjë që kishte trashëguar. Kishte sjellje brutalisht armiqësore ndaj opozitës jopenguese. Kishte sjellje jonormale ndaj ish-të burgosurve politikë, përjashto ata që i bëri pjesë të grazhdit. Një idiot si Hekuran Murati luftëtarët e UÇK-së, me një alkimi

albinkurtiane dhe vjosaosmane, i shndërroi në paramilitarë. Më shumë përmendej në mënyrë afirmative Oliver Ivanoviq dhe Zoran Gjingjiq se Baca Adem Demaçi. Hasan Prishtinën e përzunë nga Universiteti i Prishtinës, kurse Adem Jasharit ia ndaluan hyrjen në Prishtinë. Më shumë po i luftojnë dhe i urrejnë gazetarët e Kosovës se paramilitarët e Arkanit, kapetan Draganit dhe Legias. E bënë punën m.t në Maqedoni të Veriut, me mercenarin Besnik Kojen; në Mal të Zi e ndihmuan djaln politik të peshkopit Amfillohije, Abazoviqin, që ta rikthejë Serbinë dhe Rusinë, kurse në Luginë, me ndihmën e një krijese të padenjë siç është BB, prostitutë parapolitike, përçanë shqiptarët duke krijuar dhe forcuar rendin e rrogëtarëve, Sinani dhe Kamberi. Shumë para kanë derdhur për këtë. Nuk kanë lënë të zezë pa bërë, madje edhe përtej kësaj.

## Zgjedhjet në Amerikë dhe në Kosovë:



Në zgjedhjet amerikane, duket se republikanët do të fitojnë, me Trampin si president. Për qeveritarët aktualë dhe disa analistë të tyre, kjo mund të sjellë pak frikë dhe stres, por në realitet, pasoja të mëdha për Kosovën nuk priten. Faktikisht, siç duket, vëmendja për Kosovën në nivel ndërkombëtar është tkurrur, sidomos kur as ne vetë nuk po tregojmë një seriozitet të madh. Në fakt, qeveria aktuale duket se po i kushton më shumë energji dhe mbështetje Ukrainës – një vend që nuk e ka njohur ende pavarësinë e Kosovës dhe që me tolerancë të madhe justifikon aksionet e Izraelit në Gaza. Sa për diplomatën Riçard Grenell, ai nuk pritet të ketë ndikim real në vendimet e Albin Kurtit, përveçse nëse Kurti nuk i "dorëzon" vetë pozicionet e tij siç ndodhi në takimet e Brukselit dhe Ohrit. Ndërkohë, kancelari gjerman

Olaf Scholz ka krijuar një situatë që e ka vendosur Kurtin në një pozitë të vështirë, gjë që, pas zgjedhjeve gjermane, e ka lënë edhe vet Scholzin me më pak mbështetje politike.

Në politikë, ekziston një rregull që sa më shumë të dëshirosh të mbash diçka që s'të përket, aq më shumë e rrezikon humbjen. Njësoj edhe Kurti dhe Osmani po përpiqen të ruajnë pushtetin me çdo kusht, edhe pse për Kurtin situata paraqitet më e vështirë. Është ironike që Osmani ka më shumë gjasa ta rikthejë postin, ndërsa Kurti jo. Nga ana tjetër, Glauk Konjufca duket se nuk konsiderohet si një figurë e rëndësishme politike, edhe pse herë pas here bën deklarata të cilat synojnë të mbështjellin një diskurs patriotik.

Në këto zgjedhje, VV mund të luajë me çështjen e Veriut, ku sipas mendimit tim ka bërë dështimin më të madh dhe ku do të detyrohet të bëjë lëshime të mëdha. Çështjet sociale dhe ekonomike nuk priten të kenë ndonjë ndikim të madh tek votuesit, sepse elektorati nuk ka interes për të përmbysur këto politika. Tani për tani, VV nuk ka më shumë se 20-25% të votave bazë. Nëse nuk ndodh ndonjë zhvillim i papritur, maksimumi i përqindjes së VV-së do të arrijë në 30-32%. Rritje më të madhe pritet të ketë LDK, pasi mund t'i kthehen disa ish-anëtarë të Listës Guxo. As LDK dhe as PDK nuk pritet të bien nën 22%, ndërsa AAK-NISMA mund të arrijnë 8.5 deri në 9.5%. Edhe Lidhja për Familjen nuk parashikohet të bjerë nën 6%.

Këto përqindje të votave do ta sjellin VV-në në një kufi real dhe do të kontribuojnë në "pastrimin" e Kuvendit të Kosovës nga disa figura që përpiqen të mbështesin një linjë të vjetruar. VV ka pasur një mundësi historike për të bërë ndryshime reale dhe e ka shpërdoruar për keq.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Dabiqaj, 'Ylli i javës' në Superligë

**GJILAN, 1 NËNTOR** - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i Javës". Ky çmim për javën e 11-të në Albi Mall Superligë i është dhënë futbollistit të FC Drita, Albert Dabiqaj. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit. Ky komision vendosi

që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e njëmbëdhjetë t'i takojë Albert Dabiqajt, i cili ishte lojtari kyç i skuadrës së tij, FC Drita, me dy gola dhe performancë perfekte në fitoren kundër ekipit kryeqytetas, FC Prishtina (3:0). Pasi mori këtë çmim, Dabiqaj u shpreh i lumtur që u vlerësua si më i miri i javës: "Ndeshja

kundër Prishtinës është gjithmonë derbi. Ne po vinim nga tri barazime, por dje me shumë angazhim, sakrificë dhe mund arritëm ta mposhtim Prishtinën, me anën e punës që kemi bërë në stërvitje. Synimi ynë dihet, të shpallemi kampionë dhe nuk kemi asnjë tjetër në mendje. Atmosfera në ekip është e mrekullueshme.

Kemi një shtab teknik dhe lojtarë të mrekullueshëm, teksa për kryesimin dihet se sa janë të sinqertë me lojtarët. Të shpallesh më i miri i javës është privilegj dhe kënaqësi. Falënderoj bashkëlojtarët, stafin e trajnerëve dhe komisionin për vlerësimin. Ky çmim më jep më shumë motiv për ndeshjet e ardhshme".



## Sot përballet kampioni kundër liderit

**PRISHTINË, 1 NËNTOR** - Java e tetë e ProCredit Superligës do të sjellë takime interesante. Derbi i kësaj xhiroje është ndërmjet Trepçës dhe Bashkimit apo kampionit dhe liderit. Mitrovicasit kanë pesë fitore dhe dy humbje, kurse prizrenasit shtatë fitore në shtatë ndeshje, duke qenë skuadra e vetme pa humbje në elitën e basketbollit. Kjo është përballa kryesore e kësaj javë. Atmosfera në Mitrovicë pritet të jetë elektrizuese. Të shtunën do të përballen Peja me Vëllaznimin. Pejanët nuk e kanë nisur edicionin në mënyrën më të mirë të mundshme me dy fitore e pesë humbje, ndërsa kuqezinjtë kanë tri fitore e katër humbje. Sigal Prishtina do të ndeshet me Proton Cable

Prizrenin. Sfidën e parë në këtë kampionat e kishin fituar prizrenasit 100:88. "Bardhekaltrit" kanë katër fitore dhe tri humbje, kurse prizrenasit dy fitore e pesë humbje. Ndeshja e fundit e kësaj xhiro është në mes të Golden Eagle Yllit dhe Borës. Therandasit kanë katër fitore e tri humbje, ndërsa prishtinasit një fitore e gjashtë humbje.

### SUPERLIGA - Java 8

#### Të shtunën takohen:

17:00 Trepça - Bashkimi  
19:00 Peja - Vëllaznimi

#### Të dielën takohen:

17:00 Sigal Prishtina - Proton Cable  
19:00 Golden Eagle Ylli - Bora



## Feronikeli '74 tërhiqet nga vendimi për largimin nga garat



**Drenas, 1 nëntor** - Klubi drenicas Feronikeli '74 është tërhequr nga vendimi i djeshëm (e enjte) për largimin nga të gjitha garat e organizuara nga Federata e Futbollit e Kosovës (FFK). Të enjten gjatë pasdites Feronikeli '74 lëshoi një komunikatë duke konfirmuar tërheqjen nga garat pasi, sipas tyre, janë dëmtuar shumë nga gjyqtarët. Megjithatë, nuk kanë vonuar as 24 orë dhe klubi nga

"Rexhep Rexhepi" ka bërë një hap mbrapa, duke u tërhequr nga ky vendim. Është vetë presidenti i klubit nga Drenasi, Erlind Krasniqi, i cili ka konfirmuar vendimin gjatë në konferencë për medie ta mbajtur në fushën e stadiumit "Rexhep Rexhepi". "Prej kur kemi hyrë në Superligë kemi qenë klubi më i dëmtuar", ka thënë Krasniqi në konferencë. Në anën tjetër, kapiteni i Niklit, Lapidar

Lladrovic, pati një kërkesë për FFK-në. "Shpresojmë që FFK të reflektojë, sepse nuk po ndodh vetëm sivjet. Kemi qenë edhe vitin e kaluar një nga skuadrat më të dëmtuara në ligë", ka thënë Lladrovci. Ndryshe, Feronikeli '74 momentalisht zë vendin e fundit në tabelë me vetëm tri pikë nga 11 ndeshje. Klubi nga Drenasi i kthehet futbollit nesër (e shtunë), e pret Ballkanin në stadiumin "Rexhep Rexhepi".

## Rahoveci fiton derbin, vazhdon me bilanc maksimal

**RAHOVECI, 1 NËNTOR** - Rahoveci e ka fituar derbin e xhiros së tetë të Superligës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Në palestrën "Mizahir Isma", Rahoveci fitoi ndaj Besa Famgasit me rezultat 35:30. "Vreshtarët" ishin në epërsi që nga fillimi. Në pjesën e parë epërsia e vendasve shkoi deri në katër gola, por pejanët u afruan në një gol në fund të pjesës së

parë, 16:15. Në fillim të pjesës së dytë Besa Famgas barazoi 17:17. Më pas humbi disa mundësi për barazim tjetër. Dhe gabimet e Besës i shfrytëzuan vendasit që nisën shkëputjen në më shumë gola. Në 15 minutat e fundit epërsia e Rahovecit ishte më e lartë. Arbër Curri u shqua me pritje të shumta te Rahoveci në pjesën e dytë. Në pjesën e parë formë të mirë tregoi Arti Luzha.

Më efikasi te vendasit ishte Victor Alonso me 13 gola, shtatë prej tyre nga penalltia. Alban Haziri i shënoi gjashtë gola e pesë i kishte Arbios Mushkolaj. Besës nuk i kryen punë pritjet e shumta të Mursel Memetit. Më efikasi ishte Olsi Mulaj me gjashtë gola. Nga pesë i kishin Jon Vokshi e Ardit Tafilaj. Rahoveci ka gjashtë fitore në gjashtë ndeshje. Besën e mposhti

për herë të dytë. Besa Famgas ka bilanc prej katër fitore e dy humbje. Të dy skuadrat i kanë nga dy ndeshje më pak të luajtura. Në ndeshjen tjetër të zhvilluar të enjten, Prishtina fitoi 39:36 ndaj Llapit. Oltion Beshiri i kishte 11 gola për Prishtinën, katër prej tyre nga penalltia. Enis Kuleta kontribuoi me nëntë gola, derisa tetë i kishte Albi Gjuka. Ardi Halili realizoi tetë gola për



Llapjanët, derisa nga shtatë i kishin Luigj Kolaj e Arbër Neziri. Prishtina ka pesë fitore dhe tri humbje. Llapi pësoi humbjen e katërt, ndërsa i ka edhe dy fitore.

## Të hënën Dita e Draftit për JR NBA Kosova

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) njofton se të hënën është Dita e Draftit për JR NBA Kosova. Projekti i JR NBA Kosovës realizohet në bashkëpunim me Federatën e Sportit Shkollor të Republikës së Kosovës.

Ceremonia do të organizohet në Shkollën Filllore "Xhemajl Mustafa" në Prishtinë me fillim nga ora 16:00. Në ceremoni do të bëhet hedhja e shortit, ku 30 shkolla fillore të gjeneratës 11-14 vjeç janë ndarë në dy konferenca, apo gjashtë

divizione. Tetë më të mirat e Konferencës kualifikohen në "play-off" dhe më pas zhvillohet "Final Four", ku shpallet skuadra kampione. Garat do të organizohen në pesë regjione të mëdha të Kosovës si Prishtinë, Ferizaj,

Gjilan, Pejë dhe Prizren. Në regionin e Prishtinës është edhe Fushë-Kosova, në regionin e Ferizajt edhe Kaçaniku dhe Lipjani, në regionin e Gjilanit edhe Vitia, të Pejës edhe Istogu, si dhe të Prizrenit edhe Theranda. Ky do



të jetë edicioni i tretë i JR NBA Kosovës, që ka për synim zhvillimin e gjeneratave të reja.

# Messi: Arrita gjithçka që doja falë Zotit

MIAMI, 1 NËNTOR - Në një intervistë për gazetarin e famshëm italian Fabrizio Romano, futbollisti argjentinas Lionel Messi ka folur për disa tema, ndërsa ndër të tjera ka treguar se nuk dëshiron të bëhet trajner kur të përfundojë karrierën e tij futbollistike. Edhe pse nuk e ngarkon veten me plane për të ardhmen, Messi është absolutisht i sigurt për një gjë. "Unë nuk dua të jem trajner, por ende nuk jam i sigurt se çfarë do të doja të bëja në të ardhmen. Tani e vlerësoj shumë më tepër atë që bëj çdo ditë, kështu që mendoj vetëm të luaj, të stërvitem dhe të kem argëtim", ka thënë fillimisht Messi.

Paraqitja e tij për Argjentinën në Kupën e Botës 2026 është gjithashtu e pasigurt. "Sinqerisht, nuk e di. Më kanë bërë këtë pyetje disa herë, veçanërisht në Argjentinë. Shpresoj ta përfundoj sezonin në një mënyrë të mirë dhe më pas të kem përgatitje të mira, diçka që nuk e kam pasur sezonin e kaluar për shkak të kësaj do të shoh se çfarë do të ndodhë dhe si do të ndihem në futboll,



kështu që do të jetoj ditë pas dite pa menduar shumë për të ardhmen".

Messi është shumë i lumtur me karrierën e tij të pabesueshme. "Lëri njerëzit të më kujtojnë ashtu siç duan. Unë jam shumë mirënjohës për karrierën time, arrita gjithçka që doja falë Zotit. Ëndrra ime më e madhe ishte ta fitoja Kampionatin Botëror. Luftova për të për një kohë të gjatë dhe më kushtoi shumë. Kam pasur shumë fat që të fitoj gjithçka me Barcelonën, me ekipin kombëtar dhe të kem një jetë dhe familje të bukur. I jam mirënjohës

Zotit për gjithçka që kam kaluar". Ai, gjithashtu, gëzon Inter Miami, duke thënë se dëshiron ende trofe. "Ne duam titullin në MLS. Gjatë vitit kemi bërë shumë gabime qesharake që mund t'i kishim shmangur. Në play-off nuk duhet të ndodhë sepse mund të rezultojë në eliminim. Mendoj se jemi ndër favoritët. Klubi nuk ka kufij, kjo është filozofia. Tregoi se me gjithçka që ka bërë deri më tani, ne duhet të vazhdojmë të rritemi në mënyrë që të jemi të mëdhenj në MLS dhe, pse jo, në të gjithë botën", ka përfunduar argjentinas.

## Milwaukee në krizë, Utah Jazz ende pa asnjë fitore

MEMPHIS, 1 NËNTOR - Vijon kriza e skuadrës së Milwaukee, që këtë sezon në NBA ka arritur vetëm një fitore në pesë ndeshje të luajtura. Edhe ekipi i Bucksit u mund me rezultat 122-99 nga Memphis, duke mbyllur renditjen në Lindje. Antetokounmpo realizoi 37 pikë e 11 rebounde, por që s'mjaftuan, ndërsa për Memphisin shtatë lojtarë realizuan mbi 10 pikë. Jashtë fushës triumfon skuadra e Houstonit, që mundi me rezultat 108-102 Dallasin. Jalen Green me



23 pikë e 13 rebounde ishte lider për miqtë. Vijon sezoni me hope i Clippersave, që në fushën e tyre u mundën me rezultat 125-119 nga Phoenixi (Booker realizoi 40 pikë),

ndërsa San Antonion mundi me rezultat 106-88 Utah Jazzin, skuadra e vetme pa asnjë fitore këtë sezon në NBA (Wenbanayama 25 pikë).

### REZULTATET

|                         |         |
|-------------------------|---------|
| Memphis - Milwaukee     | 122-99  |
| Dallas - Houston        | 102-108 |
| Utah Jazz - San Antonio | 88-106  |
| Clippers - Phoenix      | 119-125 |

### SHKURT

#### Amorim edhe zyrtarisht trajner i Unitedit

Trajneri nga Portugalia, Ruben Amorim, edhe zyrtarisht është trajner i skuadrës së Manchester Unitedit. Ekipi nga Premierë Liga të premten e ka zyrtarizuar Amorimin, i cili në këtë pozitë zëvendëson holandezin Erik ten Hag të shkarkuar ditë më parë. Amorim ka firmosur kontratë deri në verën e vitit 2027 me klubin anglez, të cilit i është bashkuar nga Sportingu i Lisbonës, ekip me të cilin ka fituar dy tituj kampioni të Portugalisë. Në fakt, Manchester Unitedi ka paguar 11 milionë euro dëmshpërblim për t'ia shkëputur kontratën trajnerit Amorim me skuadrën portugeze. Amorim zyrtarisht do ta nisë punën te Manchester Unitedi më 11 nëntor, ndërsa deri atëherë trajner i përkohshëm do të jetë Ruud van Nistelrooy. Portugezi 39-vjeçar do të debutojë në krye të Unitedit më 24 nëntor, në ndeshjen kampionale ndaj Ipswich Town.

#### Real i ndihmon me një milion euro të prekurit nga vërshimet në Spanjë

Teksa qyteti spanjoll Valencia është i përmbetur nga uji, kjo ka bërë që edhe ndeshja e fundjavës në La Liga, ajo në mes të Valencias dhe Real Madridit, të shtyhet për një datë tjetër. E klubi i Real Madridit ka bërë me dije se ka ndarë një milion euro për t'i ndihmuar të prekurit nga përmbytjet në Valencia. Në njoftimin zyrtar të Realit thuhet se Fondacioni Real Madrid dhe Kryqi i Kuq kanë nisur një fushatë për mbledhjen e fondeve që synon t'i mbështesë të prekurit nga kjo stuhi. Sipas tyre, Real Madridi ka vendosur ta mbështesë këtë fushatë me donacionin prej një milion eurosh për t'i ndihmuar familjet e shumta që janë në një situatë kritike dhe kanë nevojë për ndihmë dhe solidaritet.

#### Cubarsi: Yamal nuk ka kufij, mund ta fitojë 'Topin e Artë'

Mbrojtësi i ri i Barcelonës, Pau Cubarsi, ka lavdëruar shokun dhe bashkëlojtarin e tij Lamine Yamal, duke thënë se ai nuk ka kufij dhe mund ta fitojë shumë shpejt "Topin e Artë". Cubarsi ishte i ftuar në një intervistë së fundmi, ku shprehu ambicien e tij për të ardhmen e tij te Barcelona. "Unë dua t'i fitoj të gjithë titujt në Barça. Dua të kaloj gjithë karrierën time këtu", ka thënë Cubarsi për "RAC1". 17-vjeçari gjithashtu lavdëroi shokun e skuadrës së Barcelonës dhe Spanjës, Lamine Yamal. "Lamine Yamal nuk ka kufij. Është e ndërlikuar ta ndalosh atë. Asnjëherë nuk e di se në cilën rrugë do të shkojë. Lamine Yamal mund ta fitojë 'Topin e Artë'. Të gjithë e shohin se kush është Lamine, por unë e njoh prej kohësh. Ai ka aftësitë e nevojshme për ta arritur atë", ka përfunduar mbrojtësi i Barçës.

## Slot: Duam të fitojmë çdo trofe te Liverpooli

Liverpooli po kalon një çast të mirë si në kampionat ashtu edhe në Ligën e Kampionëve. Skuadra e "Reds" përgatitet për një përballje të vështirë në fushën e Newcastle në Premierë Ligë. Gjithsesi, trajneri Arne Slot është

gati për një tjetër betejë, për të mos humbur kontaktin me "citizens", që kryeson me një pikë më shumë. "E dimë rëndësinë e kësaj sfide dhe jemi gati të tregojmë sesa vlejme", ka thënë Slot. "Ne duam të fitojmë çdo

trofe, në çdo turne ku marrim pjesë. Ky është objektivi ynë", u shpreh më tej Slot, që tashmë nuk i fshih ambiciet e tij te Liverpooli. "Të gjithë janë të rëndësishëm në një sezon të gjatë", ka thënë holandezi. Ai

sqaroi se klubi ka nisur bisedimet për rinovimin e kontratës së 3 lojtarëve kryesorë, që u skadon në fund të këtij sezoni. Sipas Slot, ata janë të rëndësishëm për klubin dhe të ardhmen e tij. "Negociatat me Virgil van Dijk,

Trent Alexander-Arnold dhe Mohamed Salah kanë nisur dhe s'do të jetë problem për paraqitjen e tyre në këtë sezon. Ata janë kampionë që duan të fitojnë ashtu si të gjithë", ka deklaruar Slot.

Nr: 04/24  
 Datë: 01.11.2024  
 Bazuar në Programin për Zhvillim Rural 2023 të NBPZHR, Thirrjen për Aplikim nga AZHB Nr: 6820, të datës 31.10.2023, Letër informimin - Miratimin e Projektit Nr: 3703 të datës 11.06.2024, për Masën 5: Përgatitja e Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal - qasja LEADER 2023, dhe Kontratës për financimin e Projekteve Investuese të Zhvillimit Rural Nr: 328/2024, GLV "LLAPUSHA" Malisheve shpallë:

**KONKURSI**

Për angazhimin e një eksperti për hartimin e Strategjisë Zhvillimore Lokale të GLV "LLAPUSHA" Malisheve.

**Pozita: Ekspert/e (12 ditë pune)**

**Fushëveprimtaria për pozitën:**

- Njohuri të mira për LEADER
- Zbatimi i kriterëve të LEADER
- Njohuri për programet Evropiane për zhvillimin rural (qasja LEADER)
- Identifikimin /Zhvillimin e projekteve në pajtim me Strategjinë e /zhvillimit Lokal (SZHL)

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Dëshmia për përgatitjen profesionale/Diploma Universitare
- Të dhënat personale/ CV për kandidatit
- Letra motivuese me sqarime për përvojat specifike
- Kopja e ID Republika e Kosovës
- Referencat, certifikimet dhe kualifikimet tjera

**Detyrat:**

- Takim konsultativ-informim për të gjithë anëtarët e GLV-së dhe palët me interes për qasjen LEADER dhe procesi i punës për përgatitjen e Strategjisë Zhvillimore Lokale
- Formimi i Grupeve punuese dhe formuluarëve për mbledhjen e të dhënave (anëtarët e CLV - Grupet Punuese
- Mbledhja e të dhënave për hartimin e Strategjisë - dokumentet në nivel Lokal dhe Qendrorë
- Organizimi i seminarëve në nivel lokal
- Vizita në teren - Zonat e GLV-së
- Prezantimi i Grupeve të punës për hartimin e Strategjisë dhe informimi për qasjen LEADER si dhe faza e hartimit të dokumentit
- Hartimi i profilit të GLV-së. Analiza e gjendjes ekzistuese të zonës së GLV-së
- Hartimi i analizës SWOT sipas sektorëve
- Definimi i Analizës SWOT dhe hartimi i Vizionit, qëllimeve Strategjike, objektivat dhe aktivitetet me prioritet të GLV-së
- Analiza e Projekt Ideve si bazë për definimin e prioritetëve
- Definimi i Draftit përfundimtar të Strategjisë, vendosja në shqyrtim publik-lekturimi
- Miratimi i strategjisë në kuvendin e GLV "LLAPUSHA"

**Profili:**

- Diplomë universitare
- Përvojë profesionale në zhvillimin e projekteve lidhur me bujqësi dhe zhvillim rural e mirëseardhur
- Përvojë e dëshmuar e punës me programet e financuara nga BE-ja do të ishte përparësi
- Përvojë dhe aftësi në asistimin e akterëve, komuniteteve lokale dhe komunave në zhvillimin e planeve dhe strategjive zhvillimore
- Trajnim i veçantë në fushën e zhvillimit lokal apo të qëndrueshëm do të ishte përparësi
- Përvojë e dëshmuar me komunitetet lokale, komunave dhe hartimin e Strategjive Lokale do të ishte përparësi.

**Aftësitë:**

- Aftësi shumë të mira komunikimi
- Aftësi të punojë në ekipe, mirë e organizuar, të ketë autonomi dhe dinamizëm
- Aftësi të mira në udhëheqjen e takimeve
- Të jetë i rrjedhshëm në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe (në shkrim dhe të folur)
- Të njeh punën me kompjuter dhe të jetë me aftësi të shkëlqyeshme shkrimi dhe diplomatike
- Njohuri për programet Evropiane për zhvillim rural (qasja LEADER) dhe procedurat do të jetë përparësi
- Njohuri themelore në Teknologjinë informative dhe komunikim (editim, video, multi-medie).

Konkursit do të jetë i hapur 10 ditë kalendrike nga dita e shpalljes.  
 Të interesuarit mund të dergojnë Dokumentet e kerkuara deri më 11.11.2024 në zyrën e GLV, dhe në Komunën e Malisheves, ose përmes e-mailit glvlapusha2009@gmail.com Në aplikacion duhet të cekët qartë titullin e pozitës Pozita 1.

**GLV LLAPUSHA** Malisheve

# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejpuneshejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshejte)

# RESTAURANT

# SWISS

# TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

# Lume's Details

## Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Agonesa Shehu nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit " Kuvendi i Junikut " Junik.
- Burim Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Jetmir Malushi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahar Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



Pesë vjet pa drejtorin  
e kolegun tonë

## Roland KAÇANI

Landi, vitet po ikin, por ne nuk të harrojmë. Ishe një drejtues shembull dhe i denjë i sigurimeve në Kosovë.

*E përkujton kolektivi  
i kompanisë së Sigurimeve  
“SIGMA”, dega Kosovë.*



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

